



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VASIL FYPE  
ADRESA Nr.8,Rruga e Dibres,Pallati  
335,Tirane  
TEL: 0682222143

# VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 709

Tirane më 11/04/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2022054270011146879

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER VASIL FYPE



V2022054270011146879

DATE 11/04/2022

NR REP 709

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Në Tiranë, sot më datë **11 Prill 2022 (Dymijënjëzetëdy), ditë e Hënë**, përpara meje Noterit VASIL N. FYPE, Anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me seli në Rruga e Dibres Nr. 335, u paraqitën personalisht shtetasit e mëposhtëm:

**NËNSHKRUESIT: 1) RIGERS ÇOLLAKU**, atësia Fejzi, amësia Qerime, lindur më 28/01/1987 në Berat, banues në Tiranë, Rruga Hamdi Sulçebe, Ap. 16, Njësia Administrative Nr. 4, gjendja civile “beqar”, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034298213 dhe nr. personal I70128062J.

**2) FEJZI ÇOLLAKU**, atësia Faslli, amësia Rubije, lindur më 01/08/1953 në Berat, banues në Tiranë, Rruga Hamdi Sulcebe, Nd. 278, Njësia Administrative Nr. 4, gjendja civile “i martuar”, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034298275 dhe nr. personal F30801139A. Të interesuarit janë madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Nënshkruesit më deklarojnë me vullnet të lire e të plotë se kanë hartuar **Aktin e Themelimit të Shoqërisë "IVA-TAXI"-SHPK, datë 11 Prill 2022**, bashkëlidhur këtij Vertetimi Nënshkrimi dhe e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje.

Unë Noteri, pasi e gjeta përmbajtjen e Aktit të bashkëlidhur në përputhje të plotë me Nenin 62, pika 1, germa “II”, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, **vërtetoj nënshkrimin në Aktin e Themelimit të Ortakëve të Shoqërisë “IVA-TAXI”-SH.P.K.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të Subjekteve të Nënshkrimeve të këtij Akti në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
VASIL N. FYPE



## AKT - THEMELIMI

Ne Tirane, sot me daten **11 Prill 2022 (Dymijënjëzetëdy), ditë e Hënë**, me vullnetin e tyre të lire e të plote dhe iniciativën e lire private, mbështetur :

- Ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
- Ne Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",
- Kodin Doganor dhe ligjet Fiskale të Tatimore, vendosën themelimin e Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "**IVA-TAXI**" SHPK.

### Neni 1

Themeluesit krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, të cilën do ta emërtojnë Shoqëria Tregtare "**IVA-TAXI**" SHPK

### Neni 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga 5 Maji, Pallati 44, Ap. 7, Tiranë.**

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të ndryshohet selia e shoqërisë, të hapen filiale të saj ose forma të tjera shoqërore, ashtu siç dhe do të vlerësohet në të ardhmen nga kjo Asamble.

### Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë për një afat mbi 15 vjet, duke filluar nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

### Neni 4

**Shoqëria ka për objekt:**

- **Transport udhëtarësh për llogari të vetes dhe/ose të të treta brenda vendit.**
- **Investime në fusha të ndryshme.**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të modifikohet ose ndryshojë me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, sa herë të gjykohet e nevojshme për realizimin e qëllimit social të shoqërisë.

### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 200.000 (Dyqindmije) Leke, **i ndarë në 2 (Dy) Kuota** dhe i zotëruar nga Ortaket si më poshtë:

**RIGERS ÇOLLAKU zotëron 1 (Një) Kuotë 50 % (100.000 Leke).**

**FEJZI ÇOLLAKU zotëron 1 (Një) Kuotë 50 % (100.000 Leke).**

Ky Kapital themeltar i Shoqërisë përbehet nga 100 (Njëqind) kuota, me vlerë 2.000 (Dymije) leke secila, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera nga Ortaket Themelues.

### Neni 6

Kapitali themeltar është disponuar prej ortakëve të Shoqërisë në njërën nga bankat në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të Shoqërisë në formim e sipër.

Shuma e depozituar vërtetohet nëpërmjet mandatit bankar në të cilin është shënuar edhe shuma në **200.000 (Dyqindmije) leke e këtij kapitali.**

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të shtohet ose pakesohet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### Neni 7

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt-Themelimi edhe në formë të tjera të percaktuara në Statutin e saj, i cili pas nënshkrimit nga Ortaket dhe noterizimit të tij, do të paraqitet për miratim

dhe regjistrim ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane, ne ditën e legalizimit si Person Juridik ne Shqiperi.

**Neni 8**

Ky Akt-Themelimi u hartua ne 5 kopje origjinale te barasvlershme ne gjuhen Shqipe. Nje kopje do te depozitohet tek noteri, nje tjeter do te perdoret per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nje kopje prane Deges se Tatimeve dhe kopjet e tjera do te depozitohen ne arkivin e Shoqerise.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij Akti Themelimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUESIT E SHOQERISE**

1) RIGERS ÇOLLAKU

2) FEJZI ÇOLLAKU

Rigers Çollaku

Fejzi Çollaku